

KUD 65

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË MENAXHIMIN E BURIMEVE TË FINANCIMIT TË BIZNESEVE TË VOGLA DHE TË MESME

*Msc. Fjolla Trakaniqi
fjolla.trakaniqi@uni-pr.edu*

Abstrakt

Në menaxhimin e burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë ndikojnë një numër i madh faktorësh. Në këtë punim janë trajtuar këto tema: ndikimi i llojit të biznesit në menaxhimin e burimeve financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme, madhësia dhe koha e veprimit të biznesit, ndikimi i ngritjes së efikasitetit të firmës në menaxhimin e burimeve financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme, ndikimi i pozitës ekonomike në menaxhimin e burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme.

Fjalët kyçe: Burime të financimit, menaxhimi, financimi, biznesi.

JEL kualifikimi: G, M2, M20, NO, P34.

I. Ndikimi i llojit të biznesit në menaxhimin e burimeve financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme

Lloji i biznesit ka ndikim të madh në menaxhimin e burimeve financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme. Duke u bazuar në kriterin ligjor të organizimit të bizneseve dallojmë tri lloje kryesore firmash:

- Firmat individuale (inokose),
- Ortakitë,
- Korporatat (shoqëritë aksionare).

Firmat individuale

Firmat individuale përbëjnë 80% të firmave. Këto firma mund të jenë restorante të vogla, shitore me pakicë, serviset e televizorëve, serviset e riparimeve etj. Këto firma janë pronë e një pronari të vetëm dhe drejtohen vetëm prej tij. Zakonisht pronari i biznesit është edhe menaxher dhe vet përgjigjet për borxhet dhe detyrimet e biznesit. Kapitali i këtyre firmave është i vogël mund të jetë i fituar në bazë të kursimeve ose të mirret hua. Pronari duhet të ketë aftësi për atë lloj biznesi dhe ta zhvilloi biznesin për të

=====

krijuar profit. Biznesi zhvillohet kryesisht me anëtarët e familjes apo numër të vogël të punëtorëve. Pasi që këto firma financohen nga burime vetanake, zakonisht pronarët për t'ia filluar punës burimet financiare i sigurojnë nga kursimet e tyre, nga pasuria e lënë peng, nga polisat e sigurimit ose nga huaja. Një burim tjetër i rëndësishëm për sigurimin e fondeve për biznes mund të jetë edhe rrethi familjar. Në rast se biznesi financohet nga banka dhe pronari nuk është në gjendje të kthejë borxhin atëherë banka ka të drejtë në pasurinë individuale të pronarit. Pronarët e këtyre firmave vet menaxhojnë me firmën, kanë njohuri të përgjithshme, disponojnë me autoritet të pakufizuar dhe i marrin të gjitha vendimet strategjike dhe taktike që janë të lidhura me zhvillimin e firmës dhe financimin e sajë. Çdo individ i këtij biznesi është menaxher i biznesit, vet vendos sa do të shpenzoj, çka do të prodhoj ose çfarë shërbimesh do të ofroj, a do të prodhoj produkte të reja apo do të vazhdoj me produktin e vjetër.

Përveç përparësive këto firma kanë edhe të metat e tyre. Disa nga të metat janë: përgjegjësia e pakufizuar, kufizimi në mundësitë për marrjen e kredive, vështirësitë në menaxhment, kufizimi i rritjes dhe i jetëgjatësisë, vështirësitë në zgjerimin e afarizmit etj.

Ortakitë

Ortakitë janë biznese të dy apo më shumë pronarëve të cilët e bashkojnë kapitalin e tyre dhe bëjnë biznes së bashku. Pronarët e bashkojnë punën dhe mjetet në biznes të përbashkët, për të realizuar profit ose për ta ndarë së bashku humbjen. Formimi i këtyre ndërmarrjeve është i thjeshtë sikurse të ndërmarrjet individuale. Ortakët e lidhin një kontratë me shkrim ose mund të bëjnë një marrëveshje më të thjeshtë në mënyrë që të mos kenë konflikte apo mosmarrëveshje më vonë. Këto ndërmarrje janë më të mëdha se sa ato me një ortak por më të vogla se korporatat. Zakonisht këto ndërmarrje mirren me shitjen me shumicë, me veprimtari shërbyese, shoqëri të sigurimit dhe me tregtinë e pasurive të patundshme.

Në praktikë hasim në dy tipe të ndërmarrjeve ortake:

- Ndërmarrjet e përgjithshme ortake (general partnership),
- Ndërmarrjet me ortaki të kufizuar (general and limited partners).⁸⁹

Ndërmarrjet e përgjithshme ortake kanë dy ose më shumë pronarë. Këto ndërmarrje dallohen nga ndërmarrjet individuale vetëm me numrin e pronarëve. Kjo është forma më e përhapur e ndërmarrjeve ortake. Për obligimet e marra ortakët përgjigjen në mënyrë të pakufizuar me tërë pasurinë e vet, si me pasurinë e ndërmarrjes ashtu edhe me atë personale.

89 Prof. Dr. Isak Mustafa, "Ndërmarrja në biznesin bashkëkohor", 1997, Prishtinë, fq.179.

=====

Partnerët me përgjegjësi të pakufizuar profitin e ndajnë sipas kapitalit të investuar. Mirëpo, ka raste kur mund të veprohet ndryshe, krejt kjo varet nga dëshira e partnerëve.

Ndërmarrjet ortake me përgjegjësi të kufizuar i formojnë një apo më shumë ortak. Këta ortak përgjigjen vetëm në lartësin e kapitalit të deponuar, kanë rrezik më të vogël dhe njëherit edhe pjesmarrje më të vogël në fitim. Njëherit, këta pronarë kanë kufizime edhe në udhëheqjen e ndërmarrjeve.

Te ndërmarrjet ortake me përgjegjësi të kufizuar zgjerohen bazat e financimit të ndërmarrjes. Ortakët e përgjithshëm, me sigurimin e financimit me mjetet e ortakëve, zgjerojnë afarizmin e firmës dhe njëherit mbajnë pozicionin e kontrollit në ndërmarrje. Këta pronarë të drejtat e tyre i rregullojnë nëpërmjet marrëveshjes. Ortakia mund të jetë e plotë dhe e kufizuar. Në ortakinë e plotë partnerët kanë përgjegjësi të njehta. Ndërsa, në ortakinë e kufizuar njëri partner ka përgjegjësi të pakufizuar ndërsa partnerët tjerë mund të kenë përgjegjësi të kufizuar.

Bashkimi i mjeteve të disa individëve që formojnë ortaki, mundëson krijimin e kapitalit më të madh se sa kur ndërmarrja punon vetëm me një pronar. Meqenëse një numër i vogël i partnerëve kanë përgjegjësi të kufizuar, kreditorët janë më të gatshëm t'u lejojnë kredi këtyre firmave se sa firmave me një ortak. Pra nëpërmjet ortakisë mund të sigurohen me lehtë mjetet financiare se sa në firmat individuale sepse garant të kredisë mund të paraqiten shumë partnerë të aftë që garantojnë edhe me pasurinë e vet jasht firmës. Përparësitë në menaxhmentin e kësaj ndërmarrjeje qëndrojnë në ekzistimin dhe kombinimin e aftësive, diturive, njohurive, praktikës dhe përvojave të partnerëve nga lëmenjë të ndryshëm që e kanë formuar ndërmarrjen. Partnerët mund të konsultohen për secilin vendim dhe proces të biznesit, në mënyrë që të arrihen rezultate më të mira.

Edhe ortakitë kanë përparësitë dhe të metat e veta. Disa nga përparësitë e ortakive janë: mund të sigurojnë burime më të gjëra të financimit, kanë aftësi më të lartë menaxhuese dhe organizuese, kanë jetë më të gjatë etj. Përveç përparësive i kanë edhe të metat e tyre. Ato biznese që kanë rritje më të ngadalshme nuk kanë shumë probleme mirëpo bizneset që kanë nevojë të rriten me një dinamikë më të shpejtë i kanë këto probleme: përgjegjësia e pakufizuar, jetëzgjatja e kufizuar, problem rreth transferimit të pronësisë dhe vështirësitë për të ardhur deri te kapitali më i madh.

Korporatat (shoqëritë aksionare)

Korporatat janë forma të shoqërive aksionare. Formimi i këtyre ndërmarrjeve kolektive është mënyrë e përsosur për të fituar shuma të mëdha kapitalesh. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve të mëdha në ekonomitë e

=====

zhvilluara të tregut janë në formë të korporatës. Korporatat mund të jenë të vendit, të jashtme, të mbyllura, të hapura etj.

Në kuadër të korporatës zhvillohet një sistem i ndërlikuar në mes të korporatës dhe aksionarëve. Aksionarët janë ata që e posedojnë korporatën, ata që vendosin dhe udhëheqin politikën e sajë, por nuk e posedojnë në mënyrë direkte asnjë pjesë të pasurisë së sajë.

Korporata zhvillon marrëdhënje me blerësin, me banka dhe institucione tjera që kanë karakter të huazimit të mjeteve për shumën e të cilave debiton. Me kombinimin e resursit material dhe njerëzor kryhet ndonjë prodhim apo shërbim që u shitet blerësve, kështu që mund të thuhet se korporata posedon material, paguan punëtorët me qëllim që të jep prodhimin apo ta kryej shërbimin e që si rezultat është profiti në të cilin marrin pjesë aksionarët.⁹⁰

Financimi i korporatës bëhet në mënyrë direkte me shitjen e letrave me vlerë, me dhënjën e objekteve me qira, me shitjen e mallrave dhe shërbimeve, me shitjen e aksioneve, me marrjen e kredive nga banka, me huazime nga deponuesit, me shitjen e obligacioneve etj. Nëse korporata i shet aksionet e veta ajo menjëherë e jep të drejtën e pjesëmarrjes në pronësi. Në shoqërinë aksionare dominojnë tri lloje të burimit të financimit:

- Në bazë të pronësisë nëpërmjet shitjes së aksioneve të zakonshme,
- Nëpërmes huave,
- Nëpërmes obligacioneve.

Në mes të këtyre burimeve ekzistojnë instrumente të financimit hibrid, aksionet preferenciale dhe obligacionet participuese. Si çdo ndërmarrje edhe korporata i ka përparësitë dhe të metat e veta. Korporata është forma më e përhapur në biznes dhe ka shumë më tepër përparësi në krahasim me format tjera dhe gëzon një popullaritet të deponuesit. Pasi që pronarët e aksioneve kanë përgjegjësi të kufizuar ata nuk përgjigjen për kurrfar borxhi të sajë. Ata janë pronarë të aksioneve por nuk kanë përgjegjësi. Kështu, edhe në rast rreziku, në rastin e humbjes ata e dinë se kreditorët nuk kanë të drejtë t'ua marrin pasurinë e tyre personale. Korporatën e udhëheqin drejtorët, këshilli i drejtorëve dhe menaxherët. Madhësia e korporatës lejon mundësinë e zgjedhjes së talentëve të ndryshëm për menaxhment dhe për shpërblimin e tyre. Korporatat kanë qëndrueshmëri afatgjate dhe stabilitet, vëllim të madh të punës etj. Korporata është pronare e vërtet e afarizmit dhe përgjigjet për të gjitha obligimet e veta.

Të metat e korporatave – përveç përparësive korporatat kanë edhe të metat e tyre: tatimi i dyfishtë, kontrolli jo adekuat nga ana e pronarit, rreziqet

90 Prof. Dr. Isak Mustafa, "Ndërmarrja në biznesin bashkëkohor", 1997, Prishtinë, fq.185.

=====

nga mungesa e interesit personal, mungesa e fshehtësisë dhe kontrolli gjithnjë e më i madh i shtetit.

II. Madhësia dhe koha e veprimit të biznesit

Për realizimin e afarizmit të ndërmarrjes rëndësi të vaçantë ka financimi i ndërmarrjes. Sigurimi i mjeteve financiare për themelimin e ndërmarrjes është mjaft i vështirë sidomos me rastin e themelimit të sajë, e themelimi i ndërmarrjes nuk mund të realizohet pa sigurimin e kapitalit fillestar të paraqitur në formë monetare. Varësisht nga biznesi dhe lloji i ndërmarrjes, ose në çfarë forme është themeluar ndërmarrja, a është ajo në formë me përgjegjësi të kufizur, a është ndërmarrje komandite, aksionare apo ndërmarrje me përgjegjësi të pakufizuar, varet edhe nevoja për kapital fillestar për fillimin e punës së saj. Mjetet fillestare financiare i siguron vet themeluesi i ndërmarrjes.

Këto mjete financiare mund të jenë mjete vetanake, mjete të cilat i ka deponuar vet themeluesi i ndërmarrjes. Çoftë për themelimin e ndërmarrjes, apo për vazhdimin e afarizmit të saj ndërmarrësi përveç mjeteve financiare vetanake, pjesën tjetër të mjeteve mund ta sigurojë duke shfrytëzuar mjete kreditore, bankare ose duke huazuar prej personave tjerë.

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së ndërmarrjes, ndërmarrësi, gjatë realizimit të të ardhurave mund t'i siguroj mjetet tjera financiare për vazhdimin e punës në ndërmarrje. Kështu, gjatë realizimit të të ardhurave një pjesë e fitimit ndahet për zhvillimin e afarizmit të ndërmarrjes si për blerjen e mjeteve kryesore, kapitalit punues, sigurimin e mjeteve tjera të punës etj. Një pjesë e mjeteve financiare duhet gjithmonë të ndahet për mbulimin e obligimeve ndaj personave fizik dhe juridik. Mungesa e mjeteve financiare për çfarëdo nevojë që ka ndërmarrja pengon zhvillimin efikas të ndërmarrjes. Për këtë ndërmarrja duhet përher të siguroj mjete financiare për realizimin e obligimeve të veta. Sigurimi i burimeve të financimit të biznesit varet shumë nga koha e themelimit të biznesit. Bizneset e reja e kanë shumë vështirë gjetjen e burimeve të financimit. Me kohë, kur biznesi arrinë një zhvillim më të madh, ai mund ta ketë më të lehtë sigurimin e mjeteve financiare. Sa më e suksesshme të jetë politika financiare e ndërmarrjes, ndërmarrja do të jetë më likuide.

Burimet kryesore financiare të ndërmarrjes për zhvillim më të madh të sajë mund të jenë:

- Mjetet vetanake financiare të pronarëve të ndërmarrjeve, si kapital fillestar themelues i ndërmarrjes,
- Mjetet financiare të ndara nga puna vijuese e ndërmarrjes – profiti
- Mjetet financiare të grumbulluara nga emetimi i aksioneve shtesë gjatë punës së ndërmarrjes,

=====

- Mjetet investive nga investimet e përbashkëta (joint venture) me partner strategjik të jashtëm dhe të brendshëm,
- Mjetet kreditore nga bankat komerciale,
- Mjetet kreditore nga Banka Botërore për zhvillim, Banka Evropiane për zhvillim, Fondi Monetar Ndërkombëtar,
- Mjetet nga donatorët e ndryshëm, si pjesmarrës në investime dhe burime tjera të mundshme.⁹¹

III. Ndikimi i ngritjes së efikasitetit të firmës në menaxhimin e burimeve financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme

Menaxhmenti financiar duhet të studioj, të njoh dhe të drejtoj marrëdhënjet tjera. Ngritja e efikasitetit të firmës mund t'ia lehtësoj firmës marrjen e kredive dhe në të njëjtën kohë firma ka mundësi më të mëdha që ti kthej ato me kohë. Kur firma arrinë një zhvillim, dhe kur të gjitha obligimet i kryen me kohë, fiton besim më të madh te institucionet financiare e për këtë fiton mundësi më të mëdha për të shfrytëzuar hua te këto institucione. Nga ana tjetër edhe bankat, të cilat janë burimi më i shpeshtë i financimit të firmave, më shumë preferojnë t'u japin hua firmave që janë më të sukseshme dhe atyre në të cilat kanë fituar besimin më të madh për kthimin e huasë. Ngritja e efikasitetit të firmës varet edhe nga rritja e ndërmarrjeve. Modeli i rritjes është zhvilluar në pesë faza: ekzistenca, mbijetesa, suksesi (rritja), lulëzimi dhe pjekuria. Gjatë kalimit nga një fazë në tjetrën ndërmarrja përcillet nga një lloj krize. Këto kriza janë të rëndësishme si për menaxherin ashtu edhe për biznesin. Nëse menaxheri është shumë efektiv atëherë problemet për tejkalimin e këtyre krizave gjatë kalimit të ndërmarrjes nga njëra fazë në tjetrën, do të jenë minimale.

Në fazën e parë problem i vetëm është gjetja e klientëve për produkte ose shërbime, për të depërtuar në treg dhe për të siguruar konsumatorë të mjaftueshëm. Tërë suksesi i ndërmarrjes në këtë fazë varet nga pronari për shkak se ai duhet t'i ketë të gjitha aftësitë menaxheriale. Strategjia kryesore e ndërmarrjes në këtë fazë është vetëm të mbijetoj. Kështu, në këtë fazë pronari i kryen të gjitha detyrat kryesore duke filluar nga angazhimi për mirëvajtjen e procesit të punës dhe deri te udhëheqja e financave.

Faza e dytë është faza e mbijetesës. Nëse ndërmarrja ka siguruar konsumatorë të besueshëm, sistemi i menaxhimit të ndërmarrjes është ende i thjeshtë. Qëllimi i ndërmarrjes është ende mbijetesa dhe në këtë fazë pronari – menaxheri i ndërmarrjes kryesisht merret me planifikimin e rrjedhave të

91Prof. Dr. Nazmi Mustafa, "Konferenca e pestë ndërkombëtare biznesi dhe punësimi", shtator 2006, Prishtinë, fq.21.

=====
parasë. Në këtë fazë ndërmarrja mund të rritet si për nga madhësia ashtu edhe për nga efikasiteti.

Pasi që pronari i ndërmarrjes e siguron mbijetesën e ndërmarrjes, ndërmarrja hynë në fazën e tretë, në fazën e suksesit të sajë. Në këtë periudhë ndërmarrja mund të rritet dhe tani një pjesë të përgjegjësisve të punëve të pronarit i merr menaxheri. Në këtë fazë pronari realizon rritje financiare, për këtë, detyrë e menaxherit apo menaxherëve është që duhet t'i përballojnë nevojat e punës që po rriten.

Në fazën e përparimit apo lulëzimit një nga problemet kyçe të ndërmarrjes është vazhdimësia e rritjes së shpejtë. Në këtë fazë lind problemi se si të financohet kjo rritje e shpejtë. Për këtë, detyrë e menaxherit është të zgjidh problemin e financimit dhe të vendosë për sasinë, mënyrën dhe llojin e burimeve të financimit që do t'i shfrytëzoj ndërmarrja.

Në fazën e pjekurisë së burimeve detyrë e menaxherit është kontrolli i të ardhurave financiare të ndërmarrjes. Në këtë fazë ndërmarrja ka burime financiare për të cilat mund të angazhohen në planifikimin e ndërmarrjes. Edhe resurset financiare në këtë fazë janë të rritura. Edhe pse këto janë pesë fazat nëpër të cilat duhet të kalon ndërmarrja, shumica e ndërmarrjeve nuk i përjetojnë të gjitha fazat. Disa ndërmarrje mbesin në fazën e parë të zhvillimit sepse pronarët e tyre nuk kanë aspirata për rritjen e ndërmarrjes. Zhvillimi i ndërmarrjeve apo ngritja e efikasitetit të tyre kushtëzohet nga disa faktorë të cilët duhet të plotësohen para themelimit të ndërmarrjeve, disa faktorëve tjerë të cilët duhet të plotësohen gjatë themelimit dhe disa të tjerëve që duhet të plotësohen edhe gjatë kohës së punëve. Para se të filloj punën ndërmarrja duhet të sigurohen burimet fillestare të financimit të cilat i siguron vet pronari. Sigurimi i burimeve të financimit gjatë themelimit të ndërmarrjes varet nga vet ndërmarrja, nga lloji dhe nevojat e sajë. Në mënyrë që të sigurohet zhvillim i shpejtë duhet të plotësohen disa faktorë që kanë të bëjnë me strategjinë e ndërmarrjes.

IV. Ndikimi i pozitës ekonomike në menaxhimin e burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe mesme

Rëndësia e menaxhmentit financiar varet shumë edhe nga ndikimi i pozitës ekonomike. Firma konkuron jo vetëm kundër partnerëve tjerë në të njëjtën degë, por edhe karshi kushteve ekonomike mbizotëruese. Për këtë arsye menaxhmenti financiar duhet të shohë përtej gjendjes aktuale financiare të firmës. Duke e njohur ambientin financiar ai duhet të parashikoj të ardhmen e firmës rrjedhën e parasë dhe të synojë që të arrijë objektivat e parashtruara. Rreth firmës, ndaj sajë dhe mbi aktivitetin e firmës vepron në mënyrë të ndërsjelltë ambienti që e rrethon. Mjedisin për firmën e përbëjnë firmat tjera të llojeve të ndryshme, institucionet, agjencitë, organet qeveritare

=====

me të cilat firmat hyjnë në lidhje ekonomike, në lidhje financiare apo në lidhje teknologjike. Janë këto marrëdhënie biznesi, marrëdhënie financiare dhe marrëdhënie konkurruese të një firme me subjektet tjera, të cilat marrëdhënie mund të ndodhin individualisht apo edhe bashkërisht.⁹²

Njëra ndër çështjet më të rëndësishme të menaxhmentit financiar është përcaktim i pozitës ekonomike të ndërmarrjes në funksion të burimeve të financimit të ndërmarrjes. Nga ndryshimi i burimeve financiare ndryshojnë edhe kushtet e afarizmit edhe të ekonomisë së ndërmarrjes. Kur është në pyetje kapitali vetanak ndryshon situata në likuiditet.

Edhe pse nuk njihen rregulla universale të financimit, të cilat do të vlenin në të gjitha vendet në çdo kohë, megjithatë mund të sistematizohen disa rregulla parimore të financimit.

Eksistojnë dy grupe themelore të rregullave të financimit:

- Rregullat vertikale të financimit,
- Rregullat horizontale të financimit.

Rregullat vertikale të financimit në fakt paraqesin të gjitha ato norma të financimit, të cilat mirren me strukturën e kapitalit (pasivi i bilancit të gjendjes) sipas prejardhjes dhe afateve. Këto rregulla kanë të bëjnë në mes të kapitalit vetjak dhe atij të huazuar, me marrëdhënjet në mes të rezervave dhe kapitalit vetjak si dhe marrëdhënjet në mes të plasmaneve kapitale afatgjata dhe afatshkurtra.

Rregullat horizontale të financimit kanë të bëjnë me marrëdhënjet në mes të pasurisë (aktivi i bilancit të gjendjes) dhe kapitalit (pasivi i bilancit të gjendjes). Konkretisht në grupin e rregullave horizontale të financimit bëjnë pjesë: rregullat bankare të financimit (harmonizimi i kredive të marra dhe të dhëna sipas masës dhe kushteve), rregullat bilancore të financimit (nevoja e ndarjes së pozicioneve aktive bilancore sipas shkallës së afatizimit dhe pasivit sipas afateve të arritura), rregullat e financimit 1:1 (barazimi midis mjeteve të gatshme dhe kërkesave të gatshme nga ana e aktivit dhe e kapitalit afatshkurtër nga ana e pasivit të bilancit), rregullat e financimit 2:1 (aktivi duhet të jetë dy herë më i madhë se sa masa e kapitalit afatshkurtër).⁹³

Meqenëse ndërmarrjet janë gjithnjë në marrëdhënie konkurruese me njëra tjetrën asnjë ndërmarrje nuk guxon të ngadalësojë procesin e punës sepse ekzistenca e sajë do të vihej në pyetje. Për të qenë ndërmarrja gjithmonë aktive dhe në garë me konkuresit tjerë, në të shumtën e rasteve duhet të huazojë kapital sepse ai i mungon nga vetakumulimi. Ky kapital i huazuar i nevojitet për të plotësuar ciklin e investimeve të cilin e shtynë rrethina

92 Prof. Dr. Isa Mustafa, "Menaxhmenti financiar" Botimi i dytë – 2007, Prishtinë, fq.26.

93 Prof. Dr. Berim Ramosaj, Doc. Dr. Izet Zeqiri, "Menagement", 2003, Prishtinë, fq.137.

ekonomike. Mirëpo, për të huazuar kredi është mjaftë e vështirë sepse edhe huazimi i kredisë varet nga kushtet e tregut.

Financimi i një ndërmarrjeje nuk varet gjithmonë nga dëshira e kompanisë për të ecur përpara, por shpesh herë ndikohet edhe nga rrethanat e tregut që i imponohen. Në këto kushte ndërmarrja financimin mund ta rrealizojë qoftë me kapital aksionarë për të cilin duhet të paguaj dividend, qoft me kapital të huazur për të cilin duhet të paguaj kamatë. Në kohën kur bëhet angazhimi gjithnjë e më i madh i kapitalit kompania mund të ketë zvoglim të shpenzimeve marginale. Me zvoglim të shpenzimeve marginale zvogëlohen edhe shpenzimet e prodhimit e kjo i ndihmon kompanisë të jetë në shkallën më të lartë të aftësisë konkurruese.

Përfundimi

Zhvillimi i menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë mund të kontribuojë në zhvillimin efikas të bizneseve të vogla dhe të mesme në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut. Menaxhimi i burimeve të financimit do të ndikojë në përmirësimin e pozitës materiale financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë. Menaxheri i mirë duhet praktikuar nëse sigurohen hua dhe përdoren për fitim. Një menaxhim i tillë përfshijnë: njohjen e fluksit të parave, parashikimin e nevojës për para, planifikimin e huamarrjes në një periudhë më të përshtatshme dhe vërtetimin e aftësisë paguese të biznesit.

Literatura

1. Konferenca e pestë ndërkombëtare “Biznesi dhe punësimi”, Prishtinë, 2006.
2. Kuka, Ibrahim, Justina Shiroka-Pula, Besnik Krasniqi, “Menaxhmenti dhe vendosja”, Prishtinë, 2006.
3. Mustafa, Isa, “Menaxhmenti financiar” Botimi i dytë, Prishtinë, 2007.
4. Mustafa, Isa, “Udhëheqja efiçienca dhe efektiviteti”, Prishtinë, 2004.
5. Mustafa, Isak, “Drejtori në udhëheqjen e biznesit”, Prishtinë, 1993.
6. Mustafa, Isak, “Ndërmarrja në biznesin bashkëkohorë”, Prishtinë, 1997.
7. Ramosaj, Berim, Izet Zeqiri, “Menagement”, Prishtinë, 2003.
8. Solymossy, Emeric, Safet Merovci, “Ndërmarrësia”, Prishtinë, 2006.
9. <http://sq.wikipedia.org/wiki/Menaxhimi>

=====

10. <http://www.slideshare.net/nicky201/menaxhim-pyetje-pergjigje>